



Të drejtat dhe përgjegjësitë tuaja për ndihmën në para dhe me ushqime

Your Cash and Food Assistance Rights
and Responsibilities

Emri i klientit (kryefamiljari)
Numri i identifikimit të klientit

Përgjegjësitë tuaja (Ju duhet të)

- **Na jepni informacionin që na nevojitet për të vendosur nëse kualifikoheni.**
- **Na e jepni vërtetimin kur nevojitet.** Mund të jemi në gjendje ta marrim atë për ju. Informacioni që i jepni departamentit i nënshtrohet verifikimit nga zyrtarë federalë dhe shtetërorë. Verifikimi mund të përfshijë kontakte të mëpasshme nga personeli i departamentit, përfshirë hetues të mashtrimeve.
- **Informacioni i raportuar tek Departamenti i Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore** mund të ndikojë në të drejtën për mbulim të kujdesit shëndetësor të administruar nga Autoriteti i Kujdesit Shëndetësor dhe Shkëmbimi i Përfitimeve Shëndetësore.
- **Njoftoni ndryshime** (p.sh. adresën, të ardhurat etj.) siç kërkohet në WAC 388-418-0005. Njoftojini ato deri në datën 10 të muajit të ardhshëm.
- **Bashkëpunoni me Sektorin e Ndhmës për Fëmijën (DCS)** nëse pranoni një ndihmë financiare nga TANF. Ju duhet të ndihmoni DCS të vendosë, ndryshojë ose zbatojë mbështetjen për fëmijët në kujdesin tuaj dhe të përcaktojë prindërimin (nëse është e nevojshme), siç kërkohet në WAC 388-422-0005. Mund të refuzoni të bashkëpunoni me DCS-në nëse mund të tregoni se keni një arsye të mirë për të besuar se bashkëpunimi me DCS-në ju kalon juve, fëmijët tuaj ose fëmijët nën kujdesin tuaj në rrezik të dëmtimit nga prindi që nuk ka kujdestarinë.
- **Aplikoni** dhe bëni përpjekje të arsyeshme për të siguruar të ardhura të mundshme nga burime të tjera kur kërkoni ose merrni ndihmë në para.
- **Plotësoni raportet dhe shqyrtimet e kërkuara.**
- **Ndiqni kërkesat për punë** për ndihmën në para dhe ndihmën me ushqime.
- **Na thoni** nëse dëshironi që dikush tjetër të përdorë ndihmën tuaj me ushqime për llogarinë tuaj.
- **Bashkëpunoni me rishikimet tona të kontrollit të cilësisë.**
- **Përdorni ndihmën ushqimore** vetëm për të blerë ushqime për pjesëtarët e familjes tuaj.
- **Përdorni ndihmën në para** vetëm për pjesëtarët e familjes suaj.
- Duhet të jepni **numrat e sigurimit shoqëror (SSN)** ose statusin e emigracionit vetëm për njerëzit që aplikojnë për ndihmë. Nëse zgjidhni të mos jepni numrat e SSN-në ose statusin e emigracionit për pjesëtarët e familjes që nuk aplikojnë, të ardhurat dhe burimet e të gjithë pjesëtarëve të familjes duhet të verifikohen gjithsesi, nëse është e nevojshme, për të përcaktuar të drejtën për përfitim.

Të drejta tuaja (ne duhet të)

- **Pranojmë një aplikim** me emrin, adresën dhe firmën tuaj ose firmën e përfaqësuesit tuaj të autorizuar.
- **T'ju ndihmojmë të plotësoni formularët e DSHS-së**
- **Të përpunojmë kërkesën tuaj për ndihmën me ushqime brenda 7 ditësh** nëse kualifikoheni për shërbimin e përshpejtuar.
- **T'ju japim një faturë** nëse na kërkoni një të tillë kur dorëzoni dokumente.
- **Të ju lëshojmë një vendim me shkrim**, në shumicën e rasteve, brenda 30 ditëve.
- **Mund të refuzoni të bisedoni me një hetues të Zbulimit të Hershëm të Mashtrimit (FRED)** nga Zyra e Mashtrimit dhe Përgjegjësisë. Nuk jeni të detyruar ta lejoni hetuesin të hyjë në shtëpinë tuaj. Ju mund t'i kërkoni hetuesit të kthehet në një kohë tjetër. Kjo nuk do të ndikojë në kualifikimin tuaj për ndihmë.

Të drejta tuaja (ne duhet të) vijon

- **Mund të kërkoni një seancë dëgjimore administrative** nëse nuk jeni dakord me një vendim që departamenti merr në rastin tuaj. Ju gjithashtu mund t'i kërkoni një mbikëqyrësi ose administratori që të rishikojë vendimin ose veprimin e kundërshtuar, pa ndikuar në të drejtat tuaja për një seancë dëgjimore administrative.
- **Ne duhet t'ju informojmë** për rregullin e kufirit kohor prej 60 muajsh sipas programit Ndhimë e Përkohshme për Familjet në Nevojë (TANF) dhe për kufirin kohor sipas programit Ndhimë në Para për Refugjatët (RCA), i cili fillon nga data kur kualifikoheni për herë të parë për përfitimet e refugjatëve. Nëse ajo datë është më 5 maj 2025 ose pas kësaj date, kufiri kohor është katër (4) muaj. Nëse ajo datë është para 5 majit 2025, kufiri kohor është 12 muaj. Ky afat kohor nuk zbatohet për ndihmën ushqimore ose financimet për kujdesin e fëmijës.

Gjëra që duhet të dini për kartën tuaj EBT

- **Keqpërdorimi i përfitimeve:** Përfitimet ushqimore dhe në para të shpërndara përmes kartës EBT do t'i sigurojnë DSHS-së një historik të transaksioneve ku ju i keni përdorur përfitimet tuaja. Departamenti do ta përdorë informacionin e transaksioneve në hetimet për keqpërdorimin e përfitimeve të ndihmës në para ose për shkëmbimin e përfitimeve të ndihmës ushqimore me para ose me sende të tjera me vlerë (trafikim).
- **Zëvendësimi i kartës EBT:** Mund t'ju kërkohet të paguani për zëvendësimin e kartave EBT. Mbajeni kartën tuaj EBT dhe numrin tuaj të identifikimit personal (PIN) të sigurt.
- **Kartat EBT me bilanc të lartë:** Nëse nuk i përdorni përfitimet tuaja për disa muaj me radhë ose grumbulloni një bilanc të lartë pas disa muajsh, ne mund t'ju kontaktojmë për të shqyrtuar situatën tuaj ose nevojën tuaj për përfitime.

Gjëra që duhet të dini (ndihma ushqimore bazë)

- **Ne dërgojmë informacion** për personat që aplikojnë për ndihmën ushqimore bazë tek agjenci të tjera federale për të verifikuar që informacioni është i saktë. Nëse ndonjë informacion është i pasaktë, personat që aplikojnë mund të mos e marrin ndihmën ushqimore bazë. Nëse një person jep informacion që e di se është i pasaktë, ai mund të ndiqet penalisht. Ndëshkimet për shkeljen e qëllimshme të rregullave të ndihmës ushqimore bazë variojnë nga përjashtimi nga programi, te gjobat ose ndoshta burgimi.
- **Nëse ju e shisni, përpiqeni ta shisni, e shkëmbeni ose e dhuroni ndihmën tuaj ushqimore** për çfarëdo gjëje me vlerë, si para në dorë, drogë, armë ose për çfarëdo gjëje tjetër përveç ushqimit nga një shitës i autorizuar (trafikim), ju mund të përjashtoheni nga marrja e përfitimeve të ndihmës ushqimore për një periudhë minimale prej një viti deri në një përjashtim të përjetshëm maksimal që në shkeljen e parë. Ky përjashtim vazhdon edhe nëse ju largoheni nga shteti i Uashingtonit dhe aplikoni për përfitime në një shtet tjetër.
- **Nëse ju kërkohet të merrni pjesë në kërkesat e punës për ndihmën ushqimore bazë** dhe nuk merrni pjesë, ju mund të përjashtoheni për një muaj dhe derisa të përmbushni kërkesat e punës për shkeljen e parë; për tre muaj dhe derisa të përmbushni kërkesat për shkeljen e dytë; dhe për gjashtë muaj dhe derisa t'i përmbushni për herë të tretë dhe për çdo herë pas kësaj.
- **Ju mund të hiqeni nga programi i ndihmës ushqimore bazë** për shkeljen e një rregulli të këtij programi, siç përshkruhet në paralajmërimin për ndëshkimet e ndihmës ushqimore bazë të renditur në këtë faqe.
- **Raportoni shpenzimet e familjes nëse dëshironi që departamenti t'i përfshijë këto kosto për ndihmën ushqimore bazë.** Nëse nuk i raportoni dhe nuk paraqisni prova për këto shpenzime, atëherë ju po deklaroni se nuk dëshironi që ne t'i përdorim këto shpenzime për të vendosur nëse mund të merrni më shumë ndihmë ushqimore bazë.

Gjërat që duhet t'i dini (Para në dorë - Ndhma TANF)

Duke marrë Ndhmë të Përkohshme për Familjet në Nevojë (TANF), ju ia kaloni Divizionit të Mbështetjes së Fëmijës të drejtat tuaja për mbështetjen e fëmijës dhe të bashkëshortit. Kjo do të thotë se DCS-ja mund të mbajë pagesat e prapambetura të mbështetjes që grumbullohen gjatë kohës që ju merrni TANF. DCS-ja do t'ju dërgojë mbështetjen aktuale të mbledhur gjatë kohës që ju merrni TANF.

- **Ju duhet ta njoftoni menjëherë DCS-në nëse keni marrë pagesa ose përfitime për mbështetjen e fëmijës për fëmijën ndërkohë që keni marrë ndihmën TANF.**
- **Nëse ndaloni së marri ndihmë TANF**, ju duhet ta njoftoni DCS-në për çdo ndryshim që ndikon në mbështetjen e fëmijës, si për shembull nëse fëmija nuk jeton më me ju ose nëse ndryshoni adresën.
- **Nëse merrni ndihmën TANF, ju mund të kërkoni para shtesë për të ndihmuar në pagesën e kostove të përkohshme të strehimit emergjent.**

Gjërat që duhet t'i dini (Para në dorë - Ndhma RCA)

Marrja e ndihmës në para për refugjatët (RCA):

- **Ju duhet të jeni i pamartuar ose i martuar pa fëmijë në familje.** Ju duhet të na njoftoni nëse mbeteni shtatzënë ose nëse duhet të kujdeseni për një fëmijë, sepse mund të kualifikoheni për një program tjetër përfitimesh në para.
- **Ju kualifikoheni për të marrë deri në 4 muaj ndihmë në para për refugjatët (RCA)**, bazuar në statusin tuaj të emigracionit dhe në datën kur u kualifikuat për programet dhe shërbimet federale për refugjatët.
- **Ju duhet të merrni pjesë në shërbimet e punësimit dhe trajnimit** brenda 30 ditëve nga marrja e ndihmës, të cilat mund të përfshijnë aktivitete për t'ju ndihmuar të gjeni një punë ose të mësoni anglisht. Ju mund të mos keni nevojë të merrni pjesë në këto shërbime nëse keni një aftësi të rëndë të kufizuar ose kronike, duhet të qëndroni në shtëpi për t'u kujdesur për një të rritur tjetër me aftësi të kufizuara, jeni 60 vjeç ose më shumë, ose jeni viktimë e dhunës në familje.
- **Si pjesë e kërkesave të shërbimeve të punësimit dhe trajnimit**, ju duhet të merrni pjesë në të gjitha intervistat e punës, të pranoni oferta të arsyeshme pune (përveçse kur kjo do të ishte në kundërshtim me një marrëveshje sindikale, pjesë e së cilës jeni ose kur vendi i punës është bosh për shkak të një mosmarrëveshjeje pune), dhe nuk mund të largoheni nga puna pa një arsye të vlefshme, siç përcaktohet nga ne.
- **Ju keni të drejtën për punë të përshtatshme dhe për shërbime të punësimit dhe trajnimit.** Të gjitha punët dhe shërbimet e punësimit dhe trajnimit duhet të jenë të sigurt, jodiskriminuese, të përfshijnë veprimtari që janë brenda fushës së planit tuaj individual të shërbimit për punësim/arsim dhe që ju mund t'i kryeni rregullisht, të përfshijnë orar që është i zakonshëm për atë punë dhe të jenë brenda një kohe të arsyeshme udhëtimi për në punë (jo më shumë se dy orë ose aq sa është e pranueshme për zonën). Shërbimet e trajnimit duhet t'ju mundësojnë të gjeni një pune dhe paga duhet të përmbushë ose të tejkalojë pagën minimale, ose të mos jetë dukshëm më e ulët se ajo që zakonisht paguhet për punë të ngjashme.
- **Nëse ju kërkohet të pranoni një ofertë pune ose të merrni pjesë në shërbimet e punësimit dhe trajnimit të RCA-së** dhe nuk e bëni këtë, ndihma juaj do të ndërpritet ose do të ulet. Uljet janë tre muaj për mospjesëmarrjen e parë dhe gjashtë muaj për çdo mospjesëmarrje pas kësaj.
- **Ju duhet të na raportoni çdo të ardhur nëse gjeni një punë**, deri më datën 10 të muajit pasardhës.
- **Nëse jeni me aftësi të kufizuara, i verbër ose mbi 65 vjeç**, ju mund të merrni ndihmën RCA, ndërsa aplikoni për programe të tjera ndihme pranë Administratës së Sigurimeve Shoqërore (SSA). Ne do t'ju ndihmojmë të aplikoni për ato programe. Pasi të miratoheni për një program ndihme pranë SSA-së, përfitimet tuaja të RCA-së do të ndërpritën.
- **Ju nuk mund të merrni ndihmë RCA** nëse, brenda 30 ditëve para aplikimit tuaj, e keni lënë punën ose keni refuzuar një ofertë të arsyeshme pune pa një arsye të vlefshme.

Deklaratë për të Drejtat Civile dhe Mosdiskriminimin

Në përputhje me ligjin federal për të drejtat civile dhe rregulloret e politikave të USDA-së për të drejtat civile, USDA-ja, agjencitë, zyrat, punonjësit dhe institucionet e saj që marrin pjesë ose administrojnë programe të USDA-së, e kanë të ndaluar të diskriminojnë në bazë të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, fesë, gjinisë, aftësisë së kufizuar, moshës, gjendjes civile, statusit familjar/prindëror, të ardhurave që rrjedhin nga një program i ndihmës publike, bindjeve politike ose hakmarrjes për veprimtari të mëparshme lidhur me të drejtat civile, në çdo program ose veprimtari të zhvilluar ose të financuar nga USDA-ja (jo të gjitha bazat vlejné për të gjitha programet). Mjetet juridike dhe afatet për paraqitjen e ankesave ndryshojné sipas programit ose incidentit.

Ata me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për mjete alternative komunikimi për informacionin e programit (p.sh., Braille, shkronja të mëdha, audiokasetë, gjuha amerikane e shenjave, etj.) duhet të kontaktojnë agjencinë shtetërore ose lokale që administron programin, ose të kontaktojnë USDA-në përmes Shërbimit të Telekomunikacionit Rele në numrin 711 (zanor dhe TTY). Përveç kësaj, informacion mbi programin mund të jetë i disponueshëm në gjuhë të tjera përveç anglishtes.

Për të paraqitur një ankesë për diskriminim në program, plotësoni Formularin e Ankesës për Diskriminim në Program të USDA-së, [AD-3027](#), që gjendet në internet te "Si të paraqisni një ankesë për diskriminim në program" dhe në çdo zyrë të USDA-së ose shkruani një letër drejtuar USDA-së dhe shkruani në letër të gjithë informacionin e kërkuar në formular. Për të kërkuar një kopje të formularit të ankesës, telefononi (866) 632-9992. Paraqisni formularin tuaj të plotësuar ose letrën tek USDA përmes:

1. **Postës:** USDA Food and Nutrition Service, 1320 Braddock Place, Room 334 Alexandria, VA 22314; ose
2. **Emailit:** FNSCIVILRIGHTSCOMPLAINTS@usda.gov.

Ky institucion është një ofruer me mundësi të barabarta.

Duke nënshkruar më poshtë, unë deklaroj se të drejtat dhe përgjegjësitë e mia lidhur me marrjen e përfitimeve dhe programeve të DSHS-së më janë shpjeguar. E kuptoj se, nëse refuzoj ta nënshkruaj këtë dokument, kjo nuk ndikon në kualifikimin tim, por unë përsëri jam përgjegjës për kërkesat e programit dhe i nënshtrohem ndëshkimeve të programit ose penale që zbatohen.

Firma e aplikuesit

Data

Firma e bashkaplikuesit

Data

ID ACES e stafit të DSHS-së:

Refuzoi të nënshkruajë.